**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/**
**REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME**
**ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE**

24/06/2024
Nr. i Protokollit: 02/ 679

# Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Vojnovc

E enjte, më 19 qershor 2024
Kohëzgjatja e takimit: 19:10 – 20:10
Vendi i takimit: SHF "Lasgush Poradeci"

Pjesëmarrës në takim ishin: Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi, Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emini, Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik - Kastriot Shabani, Drejtoresha e Drejtorisë për Arsim – Yllka Fejzullahu, Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa si dhe Asamblesitët- Sanie Sadiku, Zejnie Veliu dhe Besnik Seferi.

Rendi i ditës:

1. **Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027**

**Kryesuesi i Kuvendit, Adnan Ademi** : Përshëndetje për të gjithë dhe faleminderit që sot ju keni përgjigjë ftesës që të jeni në këtë takim. Ju kërkojë falje pasi u vonuam pak sepse takimi në fshatin Gjurkovc zgjati pak më shumë. Ky takim ka të bëjë me Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin 2025-2027, ne e kemi obligim ligjor që të gjitha dëgjimet publike t'i mbajmë bashkarisht me banorët dhe kësisoj sot jemi në fshatin e juaj, tani më jemi edhe në përfundim të dëgjimeve publike pasi që kemi qenë pothuajse në të gjitha fshatrat. Ne sot jemi këtu për t'i marr kërkesat të cilat ju si banorë i keni dhe t'i vendosim në Korzinës Afatmesme Buxhetore.
Është fat i mirë që buxheti i Komunës së Shtimes çdo vit po ka rritje, vitin e kaluar kur kemi qenë bashkarisht këtu, buxheti ka qenë afër 10 milion ndërsa tani për viti 2025 buxheti është afër 11 milion.
Buxheti ndahet në disa kategori mallra dhë shërbime, subvencione, investime kapitale, shpenzime komunale e kështu me rradhë. Në ditin 2025 parashihet që investimet kapitale të jenë 2 milion e 700 mijë, subvencionet parashihet që të rriten nga 350 mij në 500 mijë euro edhe tek paga dhe mëditjet është rritur buxheti nga 5 milion afërsisht në 6 milion arsyeja pse është rritur buxheti tek pagat dhe mëdtijet është se është rritur koeficienti vitin e kaluar dhe që nga shkurti i vitit 2023 kanë filluar të puntorët të cilët punojnë në administrat, shëndetësi t'i marrin pagat me rritje.
Nuk dua të marr shumë kohë dhe të flas për projektet të cila janë duke u bërë dhe të tjerat të cilat janë në proces, sot jemi këtu vetëm që t'i marrim kërkesat e juaja si banorë dhe prandaj tani do të doja që fjalën të ia kaloja juve.
Kërkesat e banorëve të fshatit :

- Gazmend Ramadani: Lagjia "Shabani", dritat dhe trotuari të rregullohen.
- Musë Shabani: Parcela e cila gjindet tek varrezat, na e është thënë që do t'i bashkangjitet pjesës së varrezave, a mund të bëhet diçka sa i përketë këtij drejtimi?
  Dhe nëse mund të bëhet rrethimi i 5 hektarve tek varrezat.
- Besart Aliu: Kur të bëhen investime është mirë që nëse një pjesa ka nevojë për kanalizim së pari të bëhet kanalizimi e më pas shtrimi i asfaltit, lagjia "Kurti", është e vetmja pjesë në fshat ku nuk kemi kanalizim.
  Nëse ka mundësi të bëhet një park, unë mund të ju ndihmoj sa i përketë pjesës së projektimit dhe vendit, si opsion e kemi një pjesë në lagjen "Kurti". Parku mund të bëhet tek pjesa afër fushës së futbollit.
- Ismet Rifati: Rruga "Kurti", ka nevojë për asfaltim dhe ndriçim.
  Kanalizimi duhet të hapet dhe të hiqen pjesët të cilat e kanë bllokuar pasi që si shkas i kësaj toka bujqësore po mbetën të pa punuara.
- Nexhmedin Mehmeti: Shkolla e fshatit tonë nuk i plotëson kushtet për fillim të procedurave të mësimit kur të fillojë mësimi në shtator, nëse është e mundur të bëhet një renovim sa më parë.
- Adrian Shabani: Të bëhet parku me lodra në mes rrugës "Mehmeti" dhe rrugës "Shabani".

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SHTIMES · OPŠTINA ŠTIMLJA
SHTIME-ŠTIMLJE

# REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
# REPUBLIC OF KOSOVO

## KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik në Vojnovc

Date: 19/06/2024

| Nr | Emri dhe Mbiemri | Nenshkrimi |
|---|---|---|
| 1 | KASTRIOT SHABANI | |
| 2 | Yllka Fejzullahu | |
| 3 | Albert Ramadani | |
| 4 | Ibrahim Shabani | |
| 5 | Musa -"- | |
| 6 | NEXHMEDIN MEHMETI | |
| 7 | Abdulla Shaban | |
| 8 | Adrian Shabani | |
| 9 | BESART SHABANI | |
| 10 | ZEKERIJA MEHMETI | |
| 11 | Gazmend Ramadani | |
| 12 | Ismet Rifati | |
| 13 | Besart Aliu | |
| 14 | Muhamet Qeriqi OJQ D+ | |
| 15 | NEXHAT FEJZULLAHU | |
| 16 | EBLIN FEJZULLAHU | |
| 17 | Fejzulla Fejzullahu | |

| | | |
|---|---|---|
| 18 | | |
| 19 | | |
| 20 | | |
| 21 | | |
| 22 | | |
| 23 | | |
| 24 | | |
| 25 | | |
| 26 | | |
| 27 | | |
| 28 | | |
| 29 | | |
| 30 | | |
| 31 | | |
| 32 | | |
| 33 | | |
| 34 | | |
| 35 | | |
| 36 | | |
| 37 | | |
| 38 | | |
| 39 | | |
| 40 | | |
| 41 | | |